

DT 10.03.20
P: 155/2 P


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA VENDORE SHKODËR

Nr. 1895 Prot

Shkodër, më: 28
26.02.2026

Lënda: Njoftim për afishim publik 30 ditor

DREJTUAR:

BASHKIA MALESI E MADHE ✓

Adresa: Koplík

Sikurse jeni në dijeni për Fshatin Reç, Njësia Administrative Shkrel, Malësi e Madhe po kryhet procesi i kalimit të tokës bujqësore nga përdorimi në pronësi.

Në fshatin e Reçit kanë rezultuar 207 kërkesa të depozituara pranë ZVASHK Malësi e Madhe dhe referuar VKM nr. 1182/2020 janë verifikuar të gjitha kërkesat.

Referuar shkresës nr 315/2 dt 14.08.2023 së Damt-së, e administruar pranë Zyrës Vendore Malësi e Madhe nr. 220/2 date 22.04.2024, rezulton se Fshati Reç ka qënë pjesë e ish-kooperativës bujqësore Shkrel.

Nga shqyrtimi i kriterëve ligjore ka rezultuar se janë legjitimuar si banorë sipas gjëndjes familjare të datës. 01.08.1991 si dhe paraqitjes së kërkesave brenda afatit 6 mujor nga hyrja në fuqi e ligjit 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në R.Sh" të fshatit 132 subjekte

Pas shqyrtimit të kriterëve ligjore ka vijuar puna me verifikimin në terren.

Gjatë verifikimit në terren për 1 (një) subjekt, prona e pretenduar, rezulton që shtrihet në fshatin Reç, referuar dhe shkresës nr. 315/1 dt. 15.08.2023 të DAMT-së, e administruar pranë DVASHK Shkodër me nr. 2645 dt. 17.08.2023.

Me qëllim saktësimin e sipërfaqes është kryer përcaktimi i normativës në zbatim të pikës 15 të VKM 1182/2020.

Për caktimin e normativës është ndjekur kjo metodologji: referuar Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM-nr. 1182 datë 24.12.2020 "Përmiratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit të pronësisë, pa shpërblim, të tokës bujqësore dhe të modelit të aktit individual të kalimit në pronësi të tokës bujqësore", konkretisht pika 15/b e kësaj VKM-je. Kartografi i zyrës ka realizuar nxjerrjen e normativës për frymë, për Fshatin Reç, ZK 3158, Njësia Administrative Shkrel.

Kjo normativë, është përcaktuar nga përlllogaritja e diferencës:

tokës së lirë bujqësore (të përcaktuar sipas kriterëve të VKM- 1182/2020), ku si procedurë është nxjerr sipërfaqja aktuale e lirë e tokës SHTET, e llojit Arë, Pemëtore, Vreshte, Ullishte;

është zbritur sipërfaqja e kanaleve vaditëse, rrugëve, si dhe llojet e pasurive truall, livadh, përrua (sipas kartës dhe dokumentacionit të DAMT), sipërfaqet e ndërtimeve dhe trualli funksional i tyre si dhe troje

(sipas ORTOFOTOS), po ashtu dhe sipërfaqja e tokës SHTET e dhënë me AMTP-të nga Njësia Administrative Shkrel. (bazuar në AMTP-të që janë të arkivuara ne Arkivën e ZVASHK Malësi e Madhe, të pa regjistruara akoma).

- numrit total të banorëve aktuale të përcjellë nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Shkrel, me shkresë nr. 3885/2 prot. hyrës ,datë 12.09.2024 ku numri i banorëve rezulton të jetë 585 banorë gjithësej.

1. Sipërfaqe totale aktuale Shtet, tokë bujqësore, sipas regjistrimit fillestare 1590626 m²
2. Sipërfaqe Troje, Rrugë , Kanale nga perputhja me hartën e DAMT 195541 m²
3. Përlllogaritja ka nxjerrë si rezultat shifrën rreth 2385 m² per frymë

Nga 207 kërkesa të subjekteve të depozituara nga Bashkia Malësi e Madhe, të shqyrtuara nga ana e DVASHK Shkodër, rezulton se:

1. 132 subjekte legjitimohen me certifikatë 1.8.1991 dhe kërkesa të paraqitura brenda afatit ligjore
-Nga këto, 21 subjekte janë konfirmuar nga Bashkia Malësi e Madhe
-21 subjekte janë proces afishimi pranë Njesisë Administrative Shkrel.
2. 22 kërkesa të subjekteve janë paraqitur jashtë afatit ligjor
3. 53 subjekte nuk legjitimohen me çertifikatë familjare të vitit 1.8.1991

Referuar çertifikatave familjare duke marrë në konsiderate numrin aktual te anëtarëve të families rezulton se subjektet e mëposhtme janë brenda normativës,dhe për këtë arsye do të vijohet me afishimin e tyre në ambientet e dukshme të fshatit për periudhën 30 ditë kalendarike .

- PREKE PASHKO GJELOSHAJ

Subjektet që tejkalojnë normën janë njoftuar të paraqesin deklaratat noteriale në të kundërt do të trajtohen sipas normës.

Duke ju falenderuar !

DREJTOR
EGLANTINA FRROKU

Eglantina
a
Frroku

Digitally signed by
Eglantina Frroku
Date: 2024.02.26 14:
+0200'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Shkodër
Date: 2024/02/28 12:46:19 +02'00'
32LySHKODER2026022812461213014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Shkodër)